



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE**

19 Shtator 2017, Prizren

**THIRRJE PËR OFERTË**

Realizimi i Hulumtimit/Anketimit "Urbanizmi në Prizren"

Realizimi i hulumtimit/anketimit është aktivitet në kuadër të projektit "Qytetet Gjithëpërfshirëse - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje, financuar nga Olof Palme International Center mbështetur nga Qeveria e Suedisë.

Qëllimi i këtij projekti është të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet gjatë këtij viti në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje të ndryshme dhe në disa fshatra të Prizrenit.

Për nevojat e projektit do të realizohet një hulumtim i cili do të punohet në përputhje me qëllimin e projektit, sipas termave të referencës dhe raporti përfundimtar duhet të dorëzohet më së largu deri në 5 nëntor 2017.

EC Ma Ndryshe fton kompanitë/konsorciumet e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për realizimin e anketimit. Kompanitë/konsorciumet e interesuara për ofertim duhet të përgatisin konceptin e realizimit të anketimit (metodat, aktivitetet, oraret etj) së bashku me ofertën financiare.

Në çmim të ofertës duhet të llogaritet/përfshihet: përgatitja e pyetësorit; shtypi i pyetësorëve (min. 800 copë); trajnimi i intervistuesve; pagesa e intervistuesve; ripërsëritja e anketimit (nëse EC Ma Ndryshe dyshon në mënyrën dhe cilësinë e anketimit); çmimi për një (1) intervistë; transporti, ushqimi dhe komunikimi i intervistuesve; organizimi i grupeve të fokusit; futja e të dhënave; përgatitja e statistikave; analiza deskriptive e të dhënave të dala nga intervistat si dhe përgatitja e raportit cilësor analitik.

Kompanitë e interesuara duhet të jenë profesionale dhe të kenë përvojë në realizimin e hulumtimeve/anketimeve. Ofertat duhet të përgatiten në 2 kopje në zarf të mbyllur dhe të dorëzohen në zyrat e EC Ma Ndryshe, Saraçët 5, 20000 Prizren, nga e hëna në të premte, nga ora 09:00- 17:00, jo më vonë se më 29 Shtator 2017 si dhe në postën elektronike në [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org), me subjekt "Realizimi i Hulumtimit/Anketimit". Termat e referencës mund ti gjeni në [www.ecmandryshe.org/konkurse](http://www.ecmandryshe.org/konkurse).

Dokumentacioni i aplikimit duhet të përmbajë edhe: certifikatën e regjistrimit të kompanisë, CV-të e stafit të propozuar, portfolion profesionale (përvojën) dhe dokumente të tjera që dëshmojnë kompetencën profesionale të kompanisë.